



Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 85/2010), nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008) dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 569/1 të datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 29 shkurt 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS SHPELLA E PESHTERRIT NË ZATRIQ TË RAHOVECIT SI MONUMENT I NATYRËS

Neni 1

Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Shpella e Peshterrit** në fshatin Zatriq të Rahovecit si monument i natyrës i karakterit gjeomorfologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të zonës buferike prej 10 m. përfshinë sipërfaqen prej **30 ari**.

Neni 2

Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur Gusar në parcelën 065-0, zona kadastrale Zatriq, nr. P-71510031-00065-0, me sipërfaqe 2715 m², e regjistruar si tokë bujqësore në pronësi publike të P.SH. e Kosoves Kuvendi Komunal i Rahovecit – Shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec.

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

- a) Dëmtimi, shkatërimi, bartja e shtresimeve të mineraleve ose fosileve, bota e gjalle e objektit speleologjik, gjetjet arkeologjike, fosileve dhe gjetjeve tjera, ndryshimi i kushteve të vendbanimit në objekt mbi të dhe në afërsi të drejtëpërdrejtë të tij
- b) Për të gjitha aktivitetet në objektin speleologjik duhet të merret leja nga Ministria e veçanërisht për:
 - i. Shfrytëzimi dhe rregullimi i objektit speleologjik dhe pjesëve të tij;
 - ii. Hapja dhe/ose mbyllja e hyrjes/ daljes në objektin speleologjik si dhe për ndertimin, përtërirjen ose sanimin e çdo objekti nëntokësor
 - iii. Kryerja e hulumtimeve shkencore dhe profesionale
 - iv. Zhytja në objekt speleologjik;

- v. Xhirimi i filmave në objektet speleologjike
- vi. Punët dhe veprimtaritë të cilat ndikojnë në veçoritë themelore, në floren dhe faunen natyrore në objektin speleologjik në/mbi sipërfaqen e tij;
- vii. Vizitat e organizuara dhe fotografimi në objekt speleologjik,
- c) Për kryerjen e hulumtimeve shkencore dhe profesionale, shoqatave speleologjike mund t'iu lëshohet leja një (1) vjeçare;
- d) Vendimi për leje përmbanë edhe kushtet për mbrojtjen e natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- a) Të gjitha masat e mbrojtjes së Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 5

Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

- a) Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,
- b) Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,
- c) Ndërimi i kulturës,
- d) Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

Neni 6

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Rahovecit.

Kujdestari është i detyruar:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,
- b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën të shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 7

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë të aktit nga autoritetit mbikëqyrës i Ministrisë së Pushtetit Lokal, në kuptim të Nenit 81 të Ligjit për qeverisje Lokale Nr.03/l- 040 .

01 Nr. 561
Rahovec, 29.02.2016

Kryesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani

